



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
**Agjencia kundër Korrupsionit**  
Agencija Protiv Korrupcije / Anti – Corruption Agency

# RAPORT

ANALIZË MBI NDJEKJEN  
DHE GJYKIMET E RASTEVE  
KORRUPTIVE NË KOSOVË

*Prishtinë, Korrik 2011*

## Përmbajtja:

<b>I.</b>	<b>HYRJE</b> .....	<b>1</b>
<b>II.</b>	<b>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT</b> .....	<b>1</b>
1.	LIDHJA E KONTRATËS SË DËMSHME .....	1
2.	SHPËRDORIM I POZITËS ZYRTARE DHE AUTORIZIMIT .....	1
3.	PËRVETËSIMI GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS .....	2
4.	MARRJA E RYSHFETIT.....	2
5.	NXJERRJA E KUNDËRLIGJËSHME E VENDIMEVE GJYQËSORE.....	2
6.	FALSIFIKIM I DOKUMENTEVE ZYRTARE .....	2
7.	ARKËTIMI DHE PAGESA E PALIGJËSHME.....	2
<b>III.</b>	<b>POLICIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b> .....	<b>3</b>
1.	Lidhja e kontrates së dëmshme .....	3
2.	Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit .....	3
3.	Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës .....	3
4.	Mashtrimi në Detyrë .....	3
5.	Marrja e Rryshfetit .....	3
6.	Dhënia e Rryshfetit .....	4
7.	Ushtrimi i Ndikimit .....	4
8.	Nxjerrja e Kundërligjëshme e Vendimeve Gjyqësore.....	4
9.	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare .....	4
10.	Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme .....	4
<b>IV.</b>	<b>DOGANAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b> .....	<b>5</b>
1.	Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit .....	5
2.	Marrja e Rryshfetit .....	6
<b>V.</b>	<b>PROKURORIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b> .....	<b>6</b>
<b>VI.</b>	<b>GJYKATAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b> .....	<b>8</b>
1.	Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit .....	8
2.	Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës .....	8
3.	Përdorim i Paautorizuar i Pasurisë.....	8
4.	Marrja e Rryshfetit.....	8
5.	Dhënia e Rryshfetit .....	8
6.	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare .....	9
7.	Ushtrim i Ndikimit, Zbulimi i Fshehtësive Zyrtare, Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme, Përvetësim i Kundërligjshëm i Pasurisë me Rastin e Bastisjes apo Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor.....	9
<b>VII.</b>	<b>KALLXIMET PENALE DHE GJYKIMET</b> .....	<b>11</b>
<b>VIII.</b>	<b>BASHKËPUNIMI NDËRINSITUCIONAL</b> .....	<b>11</b>
<b>IX.</b>	<b>MËSIMET DHE REKOMANDIMET</b> .....	<b>12</b>
	<b>LISTA E TABELAVE:</b> .....	<b>13</b>

## **I. HYRJE**

---

Agjencia kundër Korrupsionit si një mekanizmi qendror që ka mandat Parandalimin dhe Luftimin e korrupsionit me Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsionit (Ligji nr.03/L-159) në nenin 5 pika 1.14 ka kompetencë që të mbledhë, analizon dhe publikon të dhënat staistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë. Si rezultat i kësaj bashkë me të dhënat e Agjencisë janë mbeldhur të dhënat statistikore të rasteve të dyshuara korruptive edhe nga insitucionet tjera relevante që kanë për detyrë ligjore hetimin dhe ndjekjen e veprave penale me natyrë korruptive, si Policia e Kosovës, Doganat, Prokuroritë dhe Gjykatat.

Ky raport me këto të dhëna statistikore është i pari i këtij lloji të cilin e realizon Agjencia dhe si i tillë do t'iu shërbej të gjithë atyre që janë të interesuar të dijn përkitazi me atë, se sa po luftohet korrupsioni në Kosovë. Nga statistikat e nxjerra në këtë raport del se luftimi i Korrupsioni në Kosovë vazhdon të mbetet larg nivelit të dëshiruar.

Raporti përmbledhë sakt të dhënat statistikore në lidhje me atë se si insitucionet që kanë për mision luftën kundër korrupsionit ju kanë qasur këtij problemi dhe se si ato i kanë trajtuar dhe ndjekur kryerësit e veprave korruptive apo edhe denuar ata.

Në vijim pasqyrohet puna për vitin 2010 e Agjencisë kundër Korrupsionit, Doganave, Policisë së Kosovës Prokurorive dhe Gjykatave të Republikës së Kosovës, në aktivitetet që këto insitucione kanë zhvilluar në ndjekje të veprave penale me karakter korruptiv.

## **II. Agjencia kundër Korrupsionit**

---

AKK procedurën e hetimit paraprak për rastet e dyshuara për korrupsion e ka zhvilluar në mbështetje të kapitullit XXIX të Kodit Penal të Kosovës; - veprat penale kundër Detyrës Zyrtare si dhe në Kapitullin XXII të Kodit Penal të Kosovës; - veprat penale kundër Ekonomisë.

Në vitin 2010, Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) ka pranuar 430 informata për dyshime se persona të caktuar mund të jenë përfshirë në veprime korruptive. Në 165 raste AKK ka gjetur elemente bazë për fillimin e hetimeve ndaj tyre. Ndërsa pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake AKK ka konstatuar se prej 165 rasteve të raportuara për korrupsion në 29 ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale.

Në këto 29 raste ku përfshihen 101 persona AKK ka ngritur kallëzime penale dhe të njëjtat i ka përcjellë tek Policia e Kosovës dhe Prokuroritë kompetente për procedim të mëtutjeshëm për këto vepra të dyshuara korruptive.

### **1. Lidhja e Kontratës së dëmshme**

Sipas nenit 237 të Kodit Penal të Kosovës AKK ka proceduar në Prokurori një (1) rast, në të cilin janë të përfshirë tre (3) persona nën dyshimin e lidhjes së kontratës së dëmshme.

### **2. Shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit**

Bazuar në nenin 339 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka proceduar në polici një (1) rast ku është i përfshirë një (1) person, në prokurorit kompetente janë proceduar 13 raste, ku janë të përfshirë 43 persona. Numri total i rasteve që janë dërguar në Polici dhe Prokurorit e Kosovës është 14 ndërsa në to janë të përfshirë 43 persona nën dyshimin se kanë bërë vepër penale: shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit.

### 3. Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës

Sipas nenin 340 të Kodit Penal të Kosovës, Agjencia ka proceduar në Prokurorit e Kosovës gjashtë (6) raste, ku të përfshirë në to janë 34 persona nën dyshimin se kanë kryerë veprë penale përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

### 4. Marrja e ryshfetit

Bazuar në nenin 343 të Kodit Penal të Kosovës AKK ka dërguar në Policin e Kosovës një (1) rast, ku është i përfshirë një (1) person nën dyshimin e marrjes së ryshfetit.

### 5. Nxjerrja e kundërligjeshme e Vendimeve Gjyqësore

Duke u mbështetur në nenin 346 të Kodit Penal të Kosovës Agjencia ka dërguar një (1) rastë në prokurori ku janë të përfshirë dy (2) persona nën dyshimin e marrjes së kundërligjeshme të vendimit gjyqësor.

### 6. Falsifikim i dokumenteve zyrtare

Bazuar në nenin 348 të Kodit Penal të Kosovës AKK ka përcjellë pesë (5) raste në Prokurorit e Kosovës, prej të cilave tri (3) kundër personave zyrtar të qeverisë dhe dy (2) kundër personave zyrtarë të institucioneve tjera. Në këto raste janë të përfshirë 16 persona nën dyshimin se kanë kryerë veprën penale;- falsifikim i dokumentit zyrtar.

### 7. Arkëtimi dhe pagesa e paligjeshme

Sipas nenit 349 të Kodit Penal të Kosovës Agjencia ka dërguar në prokurori një (1) rast, ku është i përfshirë një (1) person nën dyshimin se ka bërë veprë penale, - arkëtim dhe pagesë të paligjeshme.

Tabela në vazhdim (*Tabela 1*) pasqyronë të dhënat e sakta të denoncimeve të AKK-së në Polici dhe kallzimet penale në Prokurorit e Kosovës.

*Tabela 1. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion nga Agjencia kundër Korrupsionit*

<b>Agjencia kundër Korrupsionit</b>					
<i>Lloji i veprës</i>	Neni i Kodit Penal të Kosovës	Numri i rasteve të Procedu në Polici	Numri i rasteve të Procedu në Prokurori	Gjithësej Raste	Gjithësej Persona
<i>Lidhja e Kontratës së dëmshme</i>	<b>237</b>		<b>1</b>	<b>1</b>	<b>3</b>
<i>Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit</i>	<b>339</b>	<b>1</b>	<b>13</b>	<b>14</b>	<b>44</b>
<i>Përvetësim Gjatë Ushtimit të Detyrës</i>	<b>340</b>		<b>6</b>	<b>6</b>	<b>34</b>
<i>Marrja e Rryshfetit</i>	<b>343</b>	<b>1</b>		<b>1</b>	<b>1</b>
<i>Nxjerrja e Kundërligjeshme e Vendimeve Gjyqësore</i>	<b>346</b>		<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>
<i>Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare</i>	<b>348</b>		<b>5</b>	<b>5</b>	<b>16</b>
<i>Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme</i>	<b>349</b>		<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>Gjithësej:</b>		<b>2</b>	<b>27</b>	<b>29</b>	<b>101</b>

Për më tej, Agjencia kundër Korrupsionit me legjislacionin dytësor e ka të rregulluar mënyrën e trajtimit të rasteve nga momenti i pranimit të informacionit nga qytetari deri te përciellja e rastit në prokurori apo edhe hudhëja e rastit si i pabazuar.

Agjencia ka një raport të mirë komunikimi me Prokurorin e shtetit dhe në shumicën e rasteve Agjencia e merr informacionin kthyes për rastet (kallzimet penale që ajo i paraqet në prokurori).

Agjencia i jepë informacionin qytetarit (denoncuesit) për çdo hapë që merret në raport me rastin e denoncuar.

### **III. Policia e Republikës së Kosovës**

---

Policia e Republikës së Kosovës gjegjësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korruptive nga informatat që i ka pranuar gjatë vitit 2010 ka punuar në gjithësej gjashtëqind e gjashtë (606) raste të dyshuara për vepra korruptive. Prej këtyre 606 rasteve, 282 raste janë nënhetime dhe 324 raste të tjera janë dërguar në Prokurori. Poashtu Policia ka ngritur kallzime penale ndaj 368 personave.

Policia e Kosovës ka punuar në 606 raste sipas këtyre veprave penale:

#### **1. Lidhja e kontrates së dëmshme**

Sipas nenit 237 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast nën hetim,
- Njëmdhjetë (11) raste i ka proceduar në prokurori, dhe
- Për gjashtë (6) persona ka bërë kallzim penal.

#### **2. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit**

Sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Dyqind e njëzet e tetë (228) raste nën hetime,
- Dyqind e dyzet (240) raste i ka proceduar në prokurori, dhe
- Për treqind e shtatë (307) persona ka bërë kallzim penal.

#### **3. Përvetësim Gjatë Ushtimit të Detyrës**

Sipas nenit 340 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Katërmhdhjetë (14) raste nën hetime,
- Njëzet e pesë (25) raste i ka proceduar në prokurori, dhe
- Për nëntë (9) persona ka bërë kallzim penal.

#### **4. Mashtrimi në Detyrë**

Sipas nenit 341 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast nën hetime,
- Një (1) rast i proceduar në prokurori.

#### **5. Marrja e Rryshfetit**

Sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Njëzet e pesë (25) raste nën hetime,
- Njëzet e tre (23) raste i ka proceduar në prokurori, dhe
- Për njëzet e një (21) persona është bërë kallzim penal.

## **6. Dhënia e Rryshfetit**

Sipas nenit 344 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Tre (3) raste nën hetime,
- Katër(4) raste i ka proceduar në prokurori, dhe
- Për katër (4) persona ka bërë kallzim penal.

## **7. Ushtrimi i Ndikimit**

Sipas nenit 345 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast i proceduar në prokurori, dhe
- Për një (1) personë është bërë kallzim penal.

## **8. Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore**

Sipas nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast i proceduar në prokurori, dhe
- Për një (1) personë është bërë kallzim penal.

## **9. Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare**

Sipas nenit 348 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Dhjetë (10) raste nën hetime,
- Gjashtëdhjetë (16) raste i ka proceduar në prokurori, dhe
- Për gjashtëdhjetë (16) persona ka bërë kallzim penal.

## **10. Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme**

Sipas nenit 349 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Dy (2) raste i ka proceduar në prokurori.

Për të gjitha llojet e veprave penale të lartpërmendura Policia e Kosovës gjëgjësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe anti Korrupsion ka hetuar 606 raste dhe ka ngritur kallzim penal ndaj 368 personave. Prej 606 rasteve të lartpërmenduar 324 i ka dërguar në Prokurori dhe 282 të tjera janë nën hetime.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtme (*Tabela 2*).

*Tabela 2. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion nga Policia e Kosovës*

<b>Policia</b>					
<b>Lloji i veprës</b>	<b>Neni i Kodit Penal të Kosovës</b>	<b>Gjithësej Numri i Rasteve</b>	<b>Derguar në Prokurori</b>	<b>Në Procedurë (Nën hetime)</b>	<b>Kallzime penale ndaj këtyre Personave</b>
<i>Lidhja e Kontratës së dëmshme</i>	<b>237</b>	12	11	1	6
<i>Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit</i>	<b>339</b>	468	240	228	307
<i>Përvetësim Gjatë Ushtimit të Detyrës</i>	<b>340</b>	39	25	14	9
<i>Mashtrimi në Detyrë</i>	<b>341</b>	2	1	1	0
<i>Marrja e Rryshfetit</i>	<b>343</b>	48	23	25	21
<i>Dhënia e Rryshfetit</i>	<b>344</b>	7	4	3	4
<i>Ushtrimi i Ndikimit</i>	<b>345</b>	1	1	0	1
<i>Nxjerrja e Kundërligjësme e Vendimeve Gjyqësore</i>	<b>346</b>	1	1	0	1
<i>Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare</i>	<b>348</b>	26	16	10	19
<i>Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme</i>	<b>349</b>	2	2	0	0
<b>Gjithësej:</b>		<b>606</b>	<b>324</b>	<b>282</b>	<b>368</b>

**Vërejtje!** Sipas Policisë së Kosovës në këto të dhëna statistikore për vitin 2010 nuk janë të përfshira shkresat dhe PPN-të e ndryshëm që janë dërguar në prokuroritë gjegjëse rajonale dhe nga të cilat nuk ka pasurë asnjë informacion kthyesë lidhur me masat e ndërmarra.

#### **IV. Doganat e Republikës së Kosovës**

Doganat e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2010 kanë proceduar nëntë (9) raste të dyshuara për korrupsion në Polici dhe në Prokurori të Republikës së Kosovës. Këto raste janë proceduar në këto dy institucione me dyshimin si vepra penale: Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit dhe si Marrje e Rryshfetit.

##### **1. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit**

Sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, Doganat e Kosovës i kanë proceduar në Policinë e Kosovës katër (4) raste, në të cilat raste dyshohet se janë të implikuar shtatë (7) persona për vepra penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit.

Ndërsa në Prokuroritë e shtetit i kanë proceduar katër (4) raste, për të cilat dyshohet se janë të implikuar dhjetë (10) persona për vepra penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit.

## 2. Marrja e Rryshfetit

Sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, Doganat e Kosovës e kanë proceduar në Prokurori të Kosovës një (1) rast, për të cilin dyshohet se është i implikuar një (1) persona për veprën penale Marrja e Rryshfetit.

Gjatë vitit 2010 Doganat e Republikës së Kosovës gjithësej i kanë proceduar në institucionet gjegjëse nëntë (9) raste të dyshura për korrupsion, në të cilat raste janë të implikuar tetëmbdhjetë (18) persona.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tablën e më poshtme (Tabela 3).

*Tabela 3. Të dhënat statistikore për rastet korruptive të proceduara në Polici dhe në Prokurori nga Doganat e Kosovës.*

<b>Doganat</b>					
<i>Lloji i veprës</i>	Neni i Kodit Penal të Kosovës	Numri i Rasteve të Proceduara në Polici	Numri i Rasteve të Proceduara në Prokurori	Gjithësej Raste	Gjithësej Persona
<i>Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit</i>	<b>339</b>	4	4	<b>8</b>	<b>17</b>
<i>Marrja e Rryshfetit</i>	<b>343</b>		1	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>Gjithësej:</b>		<b>4</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>18</b>

## V. Prokuroria e Republikës së Kosovës

Prokuroria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2010 i ka pranuar 2231 informata për veprat që kanë të bëjnë me korrupsionin në Kosovë. Prej të cilave 1051 janë informata të pranuar si Vepra Penale Kundër Detyrës Zyrtare sipas kapitullit XXIX të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe 1180 janë informata të pranuar si Vepra Penale Kundër Ekonomisë sipas kapitullit XXII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prej 1051 informatave të pranuar sipas kapitullit XXIX Prokuroria e Republikës së Kosovës gjatë gjithë vitit 2010 i ka hetuar gjithësej 368 persona, ndërsa 683 persona janë në procedurë.

Prej 368 personave që janë hetuar nga Prokuroria e Kosovës sipas kapitullit XXIX, prokuroria i ka ngritur këto kallzime penale:

- Ndaj (60) personave është ngritë propozim akuza,
- Ndaj (21) personave është ngritë propozim akuza për dhënjen e urdhërit ndëshkimor,
- Ndaj (8) personave është ngritë aktakuzë e drejtpërdrejt,
- Ndaj (98) personave është ngritë akuzë pas hetimit,
- Ndaj (44) personave ka bërë dërgim të rastit në kompetencë,
- Ndaj (69) personave është hedhur kallzim penal,
- Ndaj (13) personave është pezulluar hetimi,



- Ndaj (42) personave është pushuar hetimi,
- Ndaj (2) personave është bërë heqje dorë nga ndjekja penale, dhe
- Për (11) personave rastet janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Prej 1180 informatave të pranura sipas kapitullit XXII Prokuroria e Republikës së Kosovës gjatë gjithë vitit 2010 i ka hetuar gjithësej 679 persona, ndërsa 501 persona janë në procedurë.

Prej 679 personave që janë hetuar nga Prokuroria e Kosovës sipas kapitulli XXII, prokuroria i ka ngritur këto kallzime penale:

- Ndaj (192) personave është ngritë propozim akuza,
- Ndaj (73) personave është ngritë propozim akuza për dhënjën e urdhërit ndëshkimor,
- Ndaj (40) personave është ngritë aktakuzë e drejtpërdrejt,
- Ndaj (38) personave është ngritë akuzë pas hetimit,
- Ndaj (24) personave ka bërë dërgim të rastit në kompetencë,
- Ndaj (287) personave është hedhur kallëzim penal,
- Ndaj (17) personave është pezulluar hetimi, dhe
- Për (8) persona rastet janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Gjatë vitit prokuroria gjithësej i ka pranuar 2231 informata për korrupsion, prej të cilave 1184 janë në procedure dhe për 1047 janë përfunduar hetimet, siç po shihet edhe në tabelën e më poshtme (Tabela 4).

*Tabela 4. Të dhënat statistikore të pranura në Prokurorin e Kosovës për rastet korruptive gjatë vitit 2010.*

<b>Prokuroria</b>					
	<b>Lëndët e pranura</b>	<b>Në Procedurë</b>	<b>Kallëzimet Penale</b>	<b>Numri i Personave</b>	<b>Janë Hetuar Gjithësej</b>
<b>Kapitulli XXIX Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare.</b>	<b>1051</b>	<b>683</b>	Dërgim i rastit në Kompetencë	44	<b>368</b>
			Është hedhur kallëzimi penal	69	
			Është pezulluar hetimi	13	
			Është pushuar hetimi	42	
			Heqje dorë nga ndjekja penale	2	
			<b>Është ngrite propozim akuza</b>	<b>60</b>	
			<b>Propozim akuza për dhënjën e urdhërit ndëshkimor</b>	<b>21</b>	
			<b>Aktakuzë e drejtpërdrejt</b>	<b>8</b>	
			<b>Akuza pas hetimit</b>	<b>98</b>	
			Është zgjidhur në mënyrë tjetër	11	
<b>Kapitulli XXII Veprat Penale Kundër Ekonomisë</b>	<b>1180</b>	<b>501</b>	Dërgim i rastit në Kompetencë	24	<b>679</b>
			Është hedhur kallëzimi penal	287	
			Është pezulluar hetimi	17	
			Është pushuar hetimi	0	
			Heqje dorë nga ndjekja penale	0	
			<b>Është ngritur prpozim akuzë</b>	<b>192</b>	
			<b>Propozim akuza për dhënjën e urdhërit ndëshkimor</b>	<b>73</b>	
			<b>Aktakuzë e drejtpërdrejt</b>	<b>40</b>	
			<b>Akuza pas hetimit</b>	<b>38</b>	
Është zgjidhur në mënyrë tjetër	8				
<b>Gjithësej:</b>	<b>2231</b>	<b>1184</b>		<b>1047</b>	

## **VI. Gjykatat e Republikës së Kosovës**

---

Gjykat e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2010 kanë zgjidhur gjithësej 114 lëndë me natyrë korruptive.

Gjykatat gjatë vitit kanë gjykuar për këto lloje të veprave korruptive:

### **1. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit**

Sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kan shqiptuar këto aktvendime:

- Një (1) denim me burg,
- Dhjetë (10) denim me gjobë,
- Shtatë (7) denim me kusht,
- Dy (2) Aktëgjykim lirues,
- Gjashtë (6) aktëgjykim refuzues, dhe
- Tetëmdhjetë (18) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

### **2. Përvetësim Gjatë Ushtimit të Detyrës**

Sipas nenit 340 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kan shqiptuar këto aktvendime:

- Një (1) denim me burg,
- Dy (2) denim me gjobë,
- Pesë (5) denim me kusht,
- Dy (2) Aktëgjykim lirues, dhe
- Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

### **3. Përdorim i Paautorizuar i Pasurisë**

Sipas nenit 342 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kan shqiptuar këto aktvendime:

- Një (1) denim me burg,
- Një (1) denim me gjobë,
- Një (1) denim me kusht, dhe
- Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

### **4. Marrja e Rryshfetit**

Sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kan shqiptuar këto aktvendime:

- Një (1) denim me burg,
- Tetë (8) denim me gjobë,
- Një (1) denim tjetër,
- Dy (2) denim me kusht, dhe
- Pesë (5) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

### **5. Dhënia e Rryshfetit**

Sipas nenit 344 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kan shqiptuar këto aktvendime:

- Tre (3) denim me gjobë,
- Dy (2) denim me kusht,
- Një (1) aktëgjykim refuzues, dhe
- Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

## **6. Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare**

Sipas nenit 348 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktvendime:

- Dy (2) denim me burg,
- Një (1) denim me gjobë,
- Një (1) denim me kusht,
- Një (1) aktëgjykim refuzues, dhe
- Pesë (5) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

## **7. Ushtrim i Ndikimit, Zbulimi i Fshehtësive Zyrtare, Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme, Përvetësim i Kundërligjshëm i Pasurisë me Rastin e Bastisjes apo Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor**

Sipas neneve: 345, 347, 349 dhe 351 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktvendime:

- Katër (4) denim me gjobë,
- Një (1) denim tjetër,
- Gjashtë (6) denim me kusht,
- Një (1) aktëgjykim lirues, dhe
- Nëntë (9) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Për të gjitha llojet e veprave penale të lartpërmendura gjykatat i kanë shqiptuar: 6 denime me burg; 29 denime me gjobë; 2 denime të tjera; 24 denime me kusht; 5 aktgjykime liruese; 8 aktgjykime refuzuese; dhe 40 janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtëme (*Tabela 5*).

*Tabela 5. Të dhënat statistikore të gjykimeve që janë shqiptuar nga Gjykatat e Kosovës për rastet korruptive gjatë vitit 2010.*

<b>Gjykatat</b>									
<b>Lloji i veprës</b>	<b>Neni i Kodit Penal të Kosovës</b>	<b>Denim me Burg</b>	<b>Denim me Gjobë</b>	<b>Denim tjetër</b>	<b>Denim me Kusht</b>	<b>Aktgjykim Lirues</b>	<b>Aktgjykim Refuzues</b>	<b>Të zgjidhur në mënyrë tjetër</b>	<b>Gjithësej Lëndë të zgjidhura</b>
<i>Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit</i>	<b>339</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>0</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>18</b>	<b>44</b>
<i>Përvetësim Gjatë Ushtimit të Detyrës</i>	<b>340</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>11</b>
<i>Përdorim i Paautorizuar i Pasurisë</i>	<b>342</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>4</b>
<i>Marrja e Rryshfetit</i>	<b>343</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>17</b>
<i>Dhënia e Rryshfetit</i>	<b>344</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>7</b>
<i>Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare</i>	<b>348</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>10</b>
<i>Ushtrim i Ndikimit, Zbulimi i Fshehtësive Zyrtare, Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme, Përvetësim i Kundërligjshëm i Pasurisë me Rastin e Bastisjes apo Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor</i>	<b>345, 347, 349 dhe 351</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>9</b>	<b>21</b>
<b>Gjithësej:</b>		<b>6</b>	<b>29</b>	<b>2</b>	<b>24</b>	<b>5</b>	<b>8</b>	<b>40</b>	<b>114</b>

## **VII. Kallzimet Penale dhe Gjykimet**

---

Gjatë vitit 2010 Prokurorit e Kosovës për veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe kundër ekonomisë kan ngritur kallxime penale ndaj 530 personave. Ndërsa Gjykatat gjithsej i kan zgjidhur 114 lëndë, prej të cilave 61 janë shqiptuar dënime të ndryshme, ose ka zgjidhur përafërsisht 21.50% të lëndëve të pranura nga prokuroria.

Si rrjedhojë e kësaj del se Kosova vërtet po ballafaqohet me nivelin e lartë të Korrupsionit. Megjithatë lufta ndaj tij vazhdon të mbetet e dobët. Bazuar në të dhënat nga tabela e Gjykatave, rezultati i gjykimet të korrupsionit në Kosovë vërtet është shumë i ulët.

Nga numri i përgjigthshëm i rasteve që Policia e Kosovës Agjencia kundër Korrupsionit, Doganat apo edhe nga denoncues të tjerë i kan dërguar në prokurori e kjo në gjykata vërehet një jo efikasitet i madh i gjykimet të rasteve. Gjatë vitit 2010 Prokurorit e Kosovës kan ngritur aktakuzë (propozim akuzë, propozim akuzë për dhënjën e ndëshkimit, aktakuzë e drejtë për drejt dhe akuzë pas hetimit) ndaj 530 personave. Ndërkaq nga rezultatet e statistikave të tabelës del se gjykatat kanë shqiptuar dënim me burgë vetëm në 6 raste. Ndërsa dënimin për vepëren penale Shpërdorim të Pozitës Zyrtare dhe Autorizimit nga neni 339, edhe pse ka më së shumti kallxime penale për vitin 2010 gjykatat kanë shqiptuar vetëm një (1) dënim me burg. Në këtë rast nuk dihet pozita e zyrtarit të dënuar por është e sigurtë se nuk i takonë pozitës së lartë publike.

## **VIII. Bashkëpunimi ndërinstytucional**

---

Të pesë insitucionet e Republikës së Kosovës të cilat për mision kan luftën dhe parandalimin e korrupsionit kur është në pyetje unifikimi i sistemit duket se kan mënyra të ndryshme të funksionimit. Si rrjedhojë ekziston një situatë shumë e paqartë në mes zingjirit bashkëpunues në mes tyre.

Për shembull Prokuroria e Kosovës informatën kthyesë për hapat e marr ndaj rasteve të dyshuara korruptive ia kthenë vetëm Agjencisë, por një gjë të till nuk e bënë për Policinë dhe Doganat sado që të dy këto insitucione bëjnë kallxime penale tek Prokurorit dhe kan nevojë të dijn për lëndët që ato i dërgojn në prokurori.

Siq shihet nga tabela e të dhënave statistikore sistemit zingjiror të ndjekjeve penale nga të gjitha insitucionet i krijojnë një problem të dhënat e prokurorisë pasi që ky insitucion lëndët e dërguara nga të gjitha insitucionet i trajtonë me persona e jo me raste siq i dërgojnë tre insitucionet tjera Agjencia, Policia dhe Doganat, dhe poashtu krejt në fund edhe Gjykatat i trajtojnë si raste e jo me persona.

## **IX. Mësimet dhe Rekomandimet**

---

1. Kosova ka nevojë që në mënyr imediate të krijojë një mekanizëm të përbashkët në mes të të gjitha institucioneve ku duhet të jenë të përfaqësuar nga udhëheqësit më të lartë të këtyre insitucioneve; Agjencisë, Policisë, Doganave, Administratës Tatimore të Kosovës, Prokurorisë dhe Gjykatave;
2. Rekomandohet që ky mekanizëm koordinues t'i përcaktoj edhe politikat e hetimeve, ndaj problemeve të shumta që shfaqen sidomos në raportet e Auditorit Gjeneral. Është esenciale të ndodhë një gjë e till në mënyrë që të shmangen hetimet paralele;
3. Rekomandohet që të gjitha këto institucione ta bëjnë unifikimin e listës së cilësimit të veprave penale me karakter korruptiv duke u mbështetur në Kodin Penal të Kosovës;
4. Në mënyrë që Kosova ta ketë një sistem unik të statistikave për veprimet e dyshuara korruptive, rekomandohet që të krijohet një sistem i përbashkët i trajtimit të veprimeve korruptive, - si raste, të cilën e praktikojnë Agjencia, Policia, Doganat dhe Gjykatat apo në bazë të personave të implikuar në raste që e praktikon Prokuroria;
5. Për të pasur një pasqyrë më të sakt për të gjitha rastet korruptive dhe informacionin e nevojshëm për gjithë procesin e hetimit të rasteve, rekomandohet që sa më shpejtë që është e mundur të krijohet një bazë e të dhënave, në të cilën do të futen të dhenat për rastet e dyshuara korruptive nga të gjitha këto institucione, Agjencia, Policia, Doganat, Prokuroria dhe Gjykatat. Kësisoj do të jepet një pasqyrë shumë reale për gjithë procesin hetues të rasteve korruptive;
6. Rekomandohet që gjyqësori, lëndët me karakter korruptiv ti trajtojë me prioritet të shtuar;
7. Rekomandohet që Prokuoria ta forcojë bashkëpunimin gjatë fazës së hetimeve me institucionet ndjekëse, Agjencinë, Policinë dhe Doganat.

## **Lista e tabelave:**

---

<b><u>TABELA 1.</u></b> TË DHËNAT STATISTIKORE PËR RASTET E HETUARA PËR KORRUPSION NGA AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	2
<b><u>TABELA 2.</u></b> TË DHËNAT STATISTIKORE PËR RASTET E HETUARA PËR KORRUPSION NGA POLICIA E KOSOVËS	5
<b><u>TABELA 3.</u></b> TË DHËNAT STATISTIKORE PËR RASTET KORRUPTIVE TË PROCEDUARA NË POLICI DHE NË PROKURORI NGA DOGANAT E KOSOVËS.	6
<b><u>TABELA 4.</u></b> TË DHËNAT STATISTIKORE TË PRANUARA NË PROKURORIN E KOSOVËS PËR RASTET KORRUPTIVE GJATË VITIT 2010.	7
<b><u>TABELA 5.</u></b> TË DHËNAT STATISTIKORE TË GJYKIMEVE QË JANË SHQIPTUAR NGA GJYKATAT E KOSOVËS PËR RASTET KORRUPTIVE GJATË VITIT 2010.	10